



Drejtuar: Shoqërisë “TTA Alba Lam” shpk
Adresa: Rruga 5-maji (Fabrika e qumështit Ajka), Tiranë.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: e zgjedhur në bazë të Nenit 30 të Ligjit Nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu IV, Neni 33 është **“Procedurë e hapur”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“ Blerje kontenierë për grumbullimin e mbetjeve urbane”**.

Fondi limit: **29,153,880 (njëzet e nëntë milion e njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: Të ardhura - vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr.26 datë 23.05.2016 “Për një shtesë dhe disa ndryshime në Vendimin e Keshillit Bashkiak të Tiranës Nr.58 datë 30.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”.”.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **26.10.2016 ora 11.00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr 40 datë 10.10.2016.**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Bolt” shpk

NUIS- K91517011V

Vlera e ofertës pa TVSH është **27.011.100 (njëzet e shtatë milion e njëmbëdhjetë mijë e njëqind)lekë.**

2. Operatori ekonomik “W Center” shpk

NUIS K63029402A

S'ka Oferte ekonomike

3. Operatori ekonomik "TTA Alba Lam" shpk

NUIS J62110001L

Vlera e ofertës pa TVSH është **28.419.500** (njëzet e tetë milion e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë.

4. Operatori ekonomik "Paera"

NUIS L31505034R

S'ka Oferte ekonomike

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm :

1. Operatori ekonomik "Bolt" shpk s'kualifikohet.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Shoqëria "Bolt" shpk për të vërtetuar përvojën e sukseshme në furnizimet e ngjashme të mallrave objekt prokurimi ka paraqitur disa kontrata të ngjashme si më poshtë vijon:

1. Kontrata e lidhur me Bashkinë Pukë në dt 10.12.2013 me objekt: "Blerje konteniere per grumbullimin e mbetjeve urbane" me vlerë 5.360.000 lekë pa tvsh për të cilën është paraqitur i gjithë dolumentacioni shoqërues sikundër specifikohet në kriterin e vecante kapaciteti teknik pika 2.4 e dokumentave standarte të tenderit.
2. Kontratë të ngjashme të lidhur me Bashkinë Elbasan në dt 13.11.2013 me objekt: "Blerje konteniresh te mbetjeve urbane" me vlerë 30.080.000 lekë pa tvsh për të cilën nuk ka paraqitur vërtetim të lëshuar nga Bashkia Elbasan **për realizimin e plotë dhe të sukseshëm të kësaj kontrate duke mos përmbushur në këtë mënyrë kriteret e vecanta për kualifikim pikën 2.4 të (kapaciteti teknik).**
3. Kontrata e lidhur me Komunën Bradashesh, Elbasan në dt 05.09.2014 me objekt: "Blerje kosha plehrash (kontenierë)" me vlerë 2.299.000 lekë pa tvsh për të cilën është paraqitur i gjithë dolumentacioni shoqërues sikundër specifikohet në kriterin e vecante kapaciteti teknik pika 2.4 e dokumentave standarte të tenderit.
4. Kontrata e lidhur me Komunën Bradashesh, Elbasan në dt 06.05.2013 me afat te realizimit te kontrates 2 muaj me objekt: "Blerje kosha plehrash (kontenierë)" me vlerë 1.632.800 lekë pa tvsh është jashtë afatit 3-tre vjecar duke mos përmbushur në këtë mënyrë pikën 2.4 të kriterëve të vecanta për kualifikim (kapaciteti teknik) si edhe VKM Nr 914 dt 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 27 pika 4 ku përcaktohet se :
"Për të provuar përvojën e mëparshme Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tri viteve të fundit".
5. Kontratë të ngjashme të lidhur me Bashkinë Durrës në dt 22.04.2014 me objekt: "Blerje kazana mbeturinash" me vlerë 4.740.000 lekë pa tvsh për të cilën nuk ka paraqitur

vërtetim të lëshuar nga Bashkia Durrës për realizimin e plotë dhe të sukseshëm të kësaj kontrate duke mos përmbushur në këtë mënyrë kriteret e vecanta për kualifikim pikën 2.4 të (kapaciteti teknik).

6. Kontrata e lidhur me Bashkinë Rubik në dt 17.09.2012 me objekt: “Blerje konteniërë dhe kosha rrugore për bashkinë Rubik dhe Rrëshen” me vlerë 5.565.800 lekë pa tvsh me afat te realizimit te kontrates 60 dite është jashtë afatit 3-tre vjecar duke mos përmbushur në këtë mënyrë pikën 2.4 të kriterëve të vecanta për kualifikim (kapaciteti teknik) si edhe VKM Nr 914 dt 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 pika 4 ku përcaktohet se :

“Për të provuar përvojën e mëparshme Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tri viteve të fundit”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik “Bolt” shpk verteton përvojën e duhur vetëm me dy kontrata të ngjashme sikundër janë ajo e lidhur me Bashkinë Pukë në dt 10.12.2013 me objekt: “Blerje konteniere per grumbullimin e mbetjeve urbane” si dhe kontrata e lidhur me Komunën Bradashesh në dt 05.09.2014 me objekt: “Blerje kosha plehrash (konteniërë)” shumatorja e të cilave është në vlerën 7.659.000 (shtatë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa tvsh vlerë kjo më e vogël se sa vlera e përllorë për furnizimet e ngjashme të kontratës që prokurohet prej 11.661.552 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa tvsh.

Në këtë mënyrë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se operatori ekonomik “Bolt” shpk nuk përmbush kriteret e vecanta për kualifikim pika 2.4 e kapacitetit teknik si edhe nenin 46 pika 1 gërma (b) e Ligjit nr 9643 dt 20.11.2006 për “Prokurimin Publik “si edhe si edhe VKM Nr 914 dt 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 pika 4 ku përcaktohet se :

“Për të provuar përvojën e mëparshme Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tri viteve të fundit”.

Në vijim në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ”.

- Shoqëria “Bolt” shpk në plotësim të pikës 1, 2 dhe 3 të kriterëve të vecanta për kualifikim ka paraqitur ISO 9001-2008, ISO 14001-2004 dhe OHSAS 18001-2007 të cilat janë sandarte të lëshuara për **“Prodhim dhe tregëtim mobiljesh. Tregëtim të materialeve, artikujve industriale dhe produkteve për arredim”** objekt ky i cili nuk lidhet ngushtë dhe nuk është në përpjestim me procedurën konkrete objekt prokurimi. Në këtë mënyrë shoqëria “Bolt” shpk bie në kundërshtim me nenin 30 pika 2 të VKM Nr 914 dt 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se:

“Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

Në vijim në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur **të gjitha kriteret** që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

- Tek kërkesat për kualifikim “kapaciteti teknik” pika 4 përcaktohet se:

“Operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë duhet të paraqesë një kontenier kampion sipas kriterëve dhe specifikimeve të kërkuara në dokumentat standarte ditën dhe orën e fundit të hapjes së ofertave. Mosparaqitja e tyre është kusht për skualifikim”

Në dt. 26.10.2016 ora 11.00 që përkon me ditën dhe orën e hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik “Bolt” shpk nuk ka paraqitur kontenierin kampion referuar kriterit sa më sipërcituar i cili është kusht skualifikues dhe i shërben KVO për vlerësimin e ofertës teknike.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pas konstatimit të **mosparaqitjes së plotë të mostrave për artikullin pjesë e preventivit, si dhe mangesive të tjera sikundër janë referuar më sipër** vendosi ta **shpallë të pavlefshme këtë ofertë**, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “W Center” s’kualifikohet

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “W Center ” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “W Center ” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Paera” shpk s’kualifikohet

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Paera” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “Paera” s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë “TTA Alba Lam” shpk

me adresë: Rruga 5-maji (Fabrika e qumështit Ajka), Tiranë” se oferta paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa t.v.sh 28.419.500 (njëzet e tetë milion e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind)lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesmarrëse në këtë procedure prokurimi në mbështetje të nenit 63 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, nuk është paraqitur asnjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktor në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

